

QENDRA SHITETËRORE E PROVIMEVE



# PIRLS 2021

Testimi provues në klasën e katërt

**UDHËZUES PËR VLERËSIM**

## UDHËZUES PËR VLERËSUESIT

Qendra Shtetërore e Provimeve, para realizimit të testimit provues, përpiloi një përmbledhje detyrash të liruara (me udhëzuesin për vlerësim) nga testimet e deritanishme për PIRLS, kurse Byroja për Zhvillimin e Arsimit organizoi trajnime për përpunimin e teksteve të këtilla. Përvojën që fituat në trajnime dhe puna me nxënësit tuaj konsiderueshëm do t'ju ndihmojë gjatë vlerësimit të përgjigjeve të nxënësve.

Në test janë vendosur dy tekste: letrar – “Lepuri e paralajmëron tërmetin” dhe informativ – “Netët e papagajve të detit”. Në të dy tekstet ka dy tipe pyetjesh: me zgjedhje të shumëfishtë dhe pyetje të tipit të hapur. Para se të fillojë testimi, nxënësve detyrimisht ua lexoni orientimet të cilat gjenden në fillim të testit. Pas çdo shembulli, bëni një pushim dhe verifikoni se a e kanë kuptuar nxënësit se në ç’ mënyrë duhet të përgjigjen në pyetjet.

Për zgjidhjen e secilit prej dy teksteve janë paraparë nga 40 minuta. Mes dy pjesëve të testit, nxënësve duhet t’u jepni pushim prej 10 minutash.

Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë nxënësi i zgjidh duke plotësuar (ngjyrosur) rrethin para përgjigjes që konsideron se është e saktë. Pyetjet e llojit të hapur nxënësi i zgjidh duke shkruar përgjigje në hapësirën e dhënë. Në qoftë se gabon ose ndryshon mendje, nxënësi ka të drejtë ta shlyejë përgjigjen e parë dhe të shkruajë të re. Ju gjithmonë e vlerësoni përgjigjen e fundit të dhënë, përgjigjen e cila nuk është e shlyer.

Gjatë vlerësimit të pyetjeve të tipit të hapur, duhet t’u përmbaheni orientimeve të dhëna në vazhdim. Roli juaj është të vlerësoni se si nxënësi e ka kuptuar kërkesën, ku nuk guxon të interpretoni se çfarë ndoshta ka menduar nxënësi ose cili ka qenë qëllimi të cilin nuk ka arritur ta shndërrojë në një përgjigje adekuate. Gabimet e mundshme në drejtshkrim nuk guxojnë të ndikojnë ndaj vlerësimit të cilin e jepni për përgjigje e cila korrespondon me opsionet e ofruara në Udhëzues. Në Udhëzues detajisht është sqaruar se në cilët raste përgjigjen e vlerësoni me 0, 1, 2 ose 3 pikë, e në cilët raste shkruani shifrën 8 ose 9. Vlerësimin tuaj e vendosni duke ngjyrosur rrethin përkatës në bllokun e vlerësimit (djathtas, pranë secilës pyetje të hapur).

Ky test duhet t’ju ndihmojë që t’i vlerësoni rezultatet e punës suaj të deritanishme me nxënësit me tekste të këtij lloji dhe të planifikoni çfarë aktiviteteve të mëtejshme duhet të zhvilloni për të përmirësuar lexim-kuptimin.

Ju dëshirojmë punë të suksesshme dhe shpresojmë se kjo përvojë do të ketë efekt pozitiv në punën tuaj të mëtejshme me nxënësit.

# LEPURI PARALAJMËRON TËRMETIN

## UDHËZIM PËR VLERËSIMIN E AJTEMËVE ME ALTERNATIVA

Ajtemi 1: **C**

Ajtemi 2: **B**

Ajtemi 5: **C**

Ajtemi 6: **C**

Ajtemi 11: **B**

# UDHËZUES PËR VLERËSIMI E AJTEMËVE (DETYRAVE) TË TIPIT TË HAPUR

## LEPURI, AJTEMI 3

### 3. Ngjarjet kanë ndodhur shpejtë pasi që lepuri ka bërtitur “Tërmet!” Gjej dhe shkruaji dy fjalë të cilat e tregojnë këtë.

Lloji: Letërsi

Procesi: Analizë dhe vlerësimi i përmbajtjes, gjuhës dhe elementeve tekstuale

<b>2 – Kompetencë e plotë</b>
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të plotë të gjuhës specifike të përdorur në tregim e cila e bart renditjen e tregimit. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë dy fjalë nga fjalët që janë dhënë më poshtë.
<b>1 – Kompetencë e pjesshme</b>
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të pjesshme të gjuhës specifike të përdorur në tregim e cila e bart renditjen e tregimit. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë një nga fjalët që janë dhënë më poshtë.
<b>0 – Nuk ka kompetencë</b>
Përgjigjet nuk demonstrojnë kompetencë të gjuhës specifike të përdorur në tregim e cila e bart renditjen e tregimit. <i>Prova:</i> Përgjigjet nuk përmbajnë asnjë fjalë nga fjalët që janë dhënë më poshtë.

<b>Fjalë nga tregimi të cilat na tregojnë sa shpejtë gjërat kanë ndodhur</b>
<u>Vërejtje për vlerësuesit:</u> Është e pranueshme në qoftë se nxënësit kopjojnë fjali në të cilën përmbahet fjala. Gabime të vogla mund të paraqiten, mirëpo në qoftë se nuk e ndryshojnë kuptimin e fjalëve është e pranueshme. (Mbani mend që pyetja i referohet momentit kur lepuri për herë të parë ka bërtitur “Tërmet” në fillim të tregimit. Prandaj fjalët si “shpejtë” dhe “përnjëherë” të cilat paraqiten në fund të tregimit nuk janë të pranueshme) . <ul style="list-style-type: none"><li>- nisën vrapin</li><li>- vrapon/in</li><li>- të çmendur</li><li>- trokitnin</li><li>- të nxituar</li><li>- i/të dihat</li><li>- llomotitnin</li><li>- së shpejti</li></ul>

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
8	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
9	Nuk ka përgjigje.

## LEPURI, AJTEMI 4

### 4. Ku ka dashur luani që ta çojë lepuri?

Lloji: Letërsi

Procesi: Dallimi dhe zbulimi i informacioneve dhe mendimeve të dhëna eksplicite

<b>1 – Përgjigje të pranueshme</b>	
Përgjigjet e identifikojnë vendndodhjen e saktë ku luani ka dashur ta çojë lepuri. <u>Prova:</u> Përgjigjet mund të përmbajnë deklaratat se luani ka dashur që lepuri ta çojë në vendin ku ka ndodhur fatkeqësia e tmerrshme (tërmeti) siç është dhënë në mënyrë eksplicite në tekst. <u>Shembuj:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Atje ku fatkeqësia e tmerrshme ka ndodhur.</li><li>- Ai ka dashur që lepuri ta çojë në vendin nga ku ka filluar tërmeti.</li></ul> Ose përgjigjet mund të tregojnë se luani ka dashur që lepuri t'ia tregojë vendin ku ai për së pari herë ka menduar se ka tërmet – duke mos e ditur se kjo nuk është tërmet. <u>Shembuj:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- T'ia tregojë se ku ka qenë kur pat menduar se ka tërmet.</li><li>- Ku kishte rënë fruti i pemës.</li></ul> Ose përgjigjet i referohen asaj se luani ka dashur që lepuri ta çojë deri te shtëpia e tij ku e kishte dëgjuar goditjen e fuqishme. <ul style="list-style-type: none"><li>- Pranë shtëpisë së lepurit.</li></ul>	
<b>0 – Përgjigje të papranueshme</b>	
Përgjigjet nuk e identifikojnë vendndodhjen e saktë se ku luani ka dashur që ta çojë lepuri. <u>Prova:</u> Përgjigjet nuk përmbajnë deklaratat se luani ka dashur që lepuri ta çojë në vendin ku kishte ndodhur fatkeqësia e tmerrshme (tërmeti) ose ku për së pari herë ai kishte menduar se ka ndodhur fatkeqësia. Përgjigjet mund të përmbajnë vetëm informacione të pasakta ose të palidhura. <u>Shembuj:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ai ka dashur të shkojë deri te lumi.</li><li>- Deri në maje të malit.</li></ul>	
<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
8	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
9	Nuk ka përgjigje.

## LEPURI, AJTEMI 7

### 7. Shkruaj dy mënyrat në të cilat luani është përpjekur të bëjë që lepurit të ndjehet më mirë në fund të tregimit.

Lloji: Letërsi

Procesi: Nxjerrje e konkludimeve të drejtpërdrejta

<b>2 – Kompetencë e plotë</b>
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të plotë përmes identifikimit të dy informacioneve nga tregimi nga të cilat shihet se luani është kujdesur që lepurit të mos ndjehet inferior. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë dy nga mënyrat e përmendura më poshtë.
<b>1 – Kompetencë e pjesshme</b>
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të pjesshme përmes identifikimit të një informacioni nga tregimi nga i cili shihet se luani është kujdesur që lepurit të mos ndjehet inferior. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë një nga mënyrat e përmendura më poshtë.
<b>0 – Nuk ka kompetencë</b>
Përgjigjet nuk demonstrojnë kompetencë mbi atë se luani është kujdesur për lepurin. <i>Prova:</i> Përgjigjet nuk përmbajnë asnjë nga mënyrat e përmendura më poshtë. Ato mund të inkuadrojnë vetëm informacione të pasakta ose të paqarta mbi atë se si luani e ka trajtuar lepurin. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ai ishte i mirë me lepurin.</li><li>- Ai i ka thënë lepurit që të ndjehet më mirë.</li></ul>

<b>Mënyrat me të cilat luani është përpjekur të bëjë që lepurit të ndjehet më mirë</b>
<u>Vërejtje për vlerësuesit:</u> Cilido kombinim prej dy idesh specifike ose përgjithësimesh të bazuara në këtë listë janë të pranueshme. <ul style="list-style-type: none"><li>- Luani i ka buzëqeshur lepurit.</li><li>- Ai i ka thënë që të mos brengoset.</li><li>- Ai i ka thënë lepurit se edhe ai, po ashtu, nganjëherë frikësohet.</li><li>- I ka treguar se çfarë e ka shkaktuar “tërmetin”.</li><li>- I ka thënë që të mos frikësohet.</li><li>- E ka quajtur vëllaçko.</li><li>- Është përpjekur të bëjë që lepurit të mos ndjehet budalla.</li><li>- Ai ka qeshej. (Kjo sjellje e luanit mund të interpretohet si mënyrë që t’ia lehtësojë lepurit.)</li></ul>

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
8	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
9	Nuk ka përgjigje.

## LEPURI, AJTEMI 8

### **8. A mendon se luanit i ka pëlqyer lepuri? Çfarë ndodh në tregim që e paraqet këtë?**

Lloji: Letërsi

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<b>1 – Përgjigje të pranueshme</b>	
Përgjigjet i identifikojnë informacionet e tregimit që të bëjnë interpretime për ndjenjat e luanit ndaj lepurit. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë mendime mbi atë se si janë ndjenjat e luanit ndaj lepurit. Mendimet mbështeten me përshkrime përkatëse nga ngjarje specifike nga tregimi ose ndoshta janë përgjithësime përkatëse të cilat bazohen në ngjarjet e tregimit, që i tregojnë ndjenjat e luanit. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Po, ai e do. Ai i ka treguar lepurit se kjo nuk ka qenë tërmet.</li><li>- Jo. Unë mendoj se ai mendon se lepuri është budalla sepse ka menduar që ky është tërmet.</li><li>- Po, ai ishte aq i këndshëm me lepurin në fund të tregimit.</li></ul>	
<b>0 – Përgjigje të papranueshme</b>	
Përgjigjet nuk i identifikojnë informacionet nga tregimi që të bëjnë interpretime për ndjenjat e luanit ndaj lepurit. <i>Prova:</i> Përgjigjet mund të përmbajnë ose të mos përmbajnë mendime mbi atë se si janë ndjenjat e luanit ndaj lepurit. Mirëpo, mendimet nuk janë të mbështetura me ngjarje të cilat bazohen në tekst. Ose mendimet janë ndoshta të mbështetura me informacione jorelevante ose të pasakta. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Unë nuk mendoj ashtu. Këto janë dy kafshë të ndryshme.</li><li>- Po sepse ai po ikte bashkë ma lepurin.</li></ul>	
<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

## LEPURI, AJTEMI 9

### 9. Si ndryshojnë ndjenjat e lepurit nëpër tregim?

Në fillim të tregimit lepurit ndjehej \_\_\_\_\_  
Sepse \_\_\_\_\_  
Në fund të tregimit lepurit ndjehej \_\_\_\_\_  
Sepse \_\_\_\_\_

Lloji: Letërsi

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<b>2 – Kompetencë e plotë</b>
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të plotë e cila është rezultat i integritit të informacioneve nga i tërë teksti që të interpretohet se si kanë ndryshuar ndjenjat e lepurit nëpër tregim. <u>Prova:</u> Përgjigjet përmbajnë ndjenja përkatëse dhe sqarime për to për fillimin dhe për mbarimin e tregimit, siç është dhënë më poshtë.
<b>1 – Kompetencë e pjesshme</b>
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të pjesshme e cila është rezultat i integritit të informacioneve nga i tërë teksti që të interpretohet se si kanë ndryshuar ndjenjat e lepurit nëpër tregim. <u>Prova:</u> Përgjigjet përmbajnë ndjenja përkatëse dhe sqarime për to ose për fillimin dhe ose për mbarimin e tregimit (jo për të dy), siç është dhënë më poshtë. Ndjenjë përkatëse mund të jetë dhënë edhe për pjesën e dytë të tregimit, mirëpo pa sqarim përkatës.
<b>0 – Nuk ka kompetencë</b>
Përgjigjet nuk demonstrojnë kompetencë për ndjenjat e lepurit. <u>Prova:</u> Përgjigjet nuk përmbajnë ndjenja përkatëse dhe sqarime për to as për fillimin, as për mbarimin e tregimit, siç është dhënë më poshtë. Ndjenjë përkatëse mund të jetë dhënë edhe për njërin pjesë ose për të dy pjesët e tregimit, mirëpo pa sqarim përkatës. Vetëm informacione të gabuara ose sqarime të paqarta mund të jenë të përfshira.

<b>Ndjenja përkatëse dhe shembuj: për sqarimet</b>
<u>Vërejtje për vlerësuesit:</u> Nxënësit mund të përdorin terme të paqarta ose terme të përgjithshme që t'i përshkruajnë ndjenjat e lepurit. Në qoftë se sqarimi i kthjellon ndjenjat të cilat janë përshkruar dhe është i bazuar në tekst, pikë mund të jepet edhe për ndjenjat edhe për sqarimin.
<u>Fillimi i tregimit:</u> Përgjigjet e përshkruajnë lepurin si frikacak, të trembur ose të brengosur. <u>Shembuj për sqarimet</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Sepse kishte menduar se fillon tërmeti.</li><li>- Sepse kishte ndjerë tërmet.</li><li>- Sepse nuk e kishte ditur se çdo të ndodh me të.</li></ul>
<u>Fundi i tregimit:</u> Përgjigjet përshkruajnë se lepurit ka ndjerë lehtësim ose se është ndjerë budalla. <u>Shembuj për sqarimet</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Sepse ka mësuar se nuk ka pasur tërmet të vërtetë.</li><li>- Sepse luani ka bërë që ai të ndjehet i sigurt.</li><li>- Sepse ai kishte bërë aq zhurmë për asgjë.</li></ul>

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
8	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
9	Nuk ka përgjigje.



## LEPURI, AJTEMI 10

### 10. Nga ajo që po bëjnë në tregim, ti mësove se si janë luani dhe lepuri. Përshkruaje se në çfarë dallojnë luani dhe lepuri dhe çfarë bën secili prej tyre, gjë që e tregon këtë?

Lloji: Letërsi

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<p><b>3 – Kompetencë gjithëpërfshirëse</b></p> <p>Përgjigjet demonstrojnë kompetencë gjithëpërfshirëse e cila është rezultat i integritit të informacioneve nga i tërë teksti për mbështetje të plotë të interpretimeve dhe krahasimeve mbi atë se si personazhet e tregimit janë sjellë.</p> <p><u>Prova:</u></p> <p>Përgjigjet përmbajnë kompetencë për dallimet mes luanit dhe lepurit me përshkrimin e veçorive të karakterit të tyre të cilat janë të kundërta dhe me sigurimin e aktiviteteve specifike për secilën veçmas me çka i mbështetin veçoritë e shkruara.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Lepuri nuk ka menduar. Ai vetëm ka vrapuar sa ka mundur më shpejtë kur e ka dëgjuar zhurmën pa e shikuar se çfarë është ajo. Luani ka qenë i mençur. Ai e ka detyruar lepurin të kthehet prapa që të shikojë se çfarë e ka shkaktuar zhurmën.</li><li>- Lepuri është gjithmonë i trembur. Ai kërcen gjithmonë kur dëgjon zhurmë. Luani nuk është frikacak. Ai shkoi të shikojë se a ka me të vërtetë tërmet.</li></ul> <p>Ose përgjigjet përmbajnë deklaratë të përbashkët për veçoritë e tyre, mirëpo nuk mbështetet me aktivitete specifike.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ata bëjnë punë të ndryshme kur janë në rrezik. Lepuri ik gjithmonë kur dëgjon zhurmë. Luani dëshiron të shikojë se çfarë e shkakton atë zhurmë.</li></ul>
<p><b>2 – Kompetencë e mjaftueshme</b></p> <p>Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të mjaftueshme për veçoritë e personazheve.</p> <p><u>Prova:</u></p> <p>Përgjigjet përmbajnë kompetencë për dallimet mes luanit dhe lepurit me përshkrimin e veçorive të karakterit të tyre të cilat janë të kundërta, por nuk sigurojnë aktivitete specifike për secilën veçmas me çka do t'i mbështetnin veçoritë e shkruara ose këtë e bëjnë vetëm për njëren veçori.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Luani është trim, kurse lepuri nervoz. Luani është kthyer që ta shikojë “tërmetin”.</li><li>- Lepuri gjithmonë është trembur se ndoshta do të ketë tërmet. Luani ka qenë shumë i arsyeshëm dhe i mençur.</li><li>- Luani nuk është trembur nga tërmeti. Kur luani e lëshoi frutin të bjerë ai nuk ishte trembur si lepuri – ai ishte i relaksuar.</li><li>- Lepuri dhe luani janë të ndryshëm sepse luani është trim dhe i fortë, kurse lepuri është frikacak dhe i brengosur.</li><li>- Lepuri ishte mjaft i trembur nga tërmeti, e luani jo.</li><li>- Mendoj se dallohen sepse lepuri gjithmonë është i brengosur, kurse luani gjithmonë i verifikon gjërat para se të ndërmerë diçka.</li></ul> <p>Ose përgjigjja përmban aktivitete specifike të cilat janë ndërmarrë nga secili prej tyre, mirëpo nuk përmban përshkrimin e veçorive të karakterit të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Lepuri është i ndryshëm nga luani sepse lepuri paralajmëronte se do të ndodh tërmet, kurse luani e ka bindur se kjo nuk është tërmet.</li></ul>

10. Nga ajo që po bëjnë në tregim, ti mësove se si janë luani dhe lepuri. Përshkruaje se në çfarë dallojnë luani dhe lepuri dhe çfarë bën secili prej tyre, gjë që e tregon këtë?  
(vazhdon)

<b>1 – Kompetencë minimale</b>	
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të kufizuar të dallimeve në sjellje mes personazheve të tregimit. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë aktivitete ose përshkrim të tipareve vetëm për një personazh të tregimit. <i>Shembuj:</i>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lepuri ka ikur sepse ka menduar se ka tërmet.</li> <li>- Luani ka dashur të shikojë ku ka ndodhur tërmeti.</li> <li>- Lepuri është sjellë si frikacak.</li> <li>- Luani ka qenë i mençur.</li> </ul>	
<b>0 – Kompetencë e pamjaftueshme</b>	
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë jo të mjaftueshme të dallimeve në sjellje mes personazheve të tregimit. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë përgjithësime jo adekuate për sjelljen e luanit dhe lepurit. Asnjë përgjithësim nuk mbështetet me informacione specifike dhe adekuate nga teksti. Ata mund të përmbajnë edhe veçori fizike të luanit dhe lepurit të cilat nuk janë relevante për pyetjen e dhënë. <i>Shembuj:</i>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lepuri është trim.</li> <li>- Luani është më i madh se lepuri.</li> </ul>	

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
8	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
9	Nuk ka përgjigje.

## **NETËT E PAPAGAJVE TË DETIT**

### **UDHËZIM PËR VLERËSIMIN E AJTEMËVE ME ALTERNATIVA**

Ajtemi 1:      Ç

Ajtemi 2:      C

Ajtemi 3:      C

Ajtemi 4:      B

Ajtemi 5:      B

Ajtemi 6:      A

Ajtemi 9:      Ç

Ajtemi 11:     Ç

## UDHËZUES PËR VLERËSIMI E AJTEMËVE (DETYRAVE) TË TIPIT TË HAPUR

### PAPAGAJTË E DETIT, AJTEMI 7

#### 7. Sqaro se si Hana e përdorën llambën elektrike për t'i shpëtuar papagajtë e detit.

Lloji: Informativ

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<b>2 - Kompetencë e plotë</b>	<p>Përgjigje që tregojnë kompetencë të plotë përmes integritit të informacioneve specifike nga teksti për të sqaruar se si Hana e përdorën llambën elektrike.</p> <p><u>Prova:</u> Përgjigjja përmban sqarim përkatës mbi atë se si Hana e përdorën llambën elektrike. Sqarimi përfshin përmendje eksplicite të shpëtimit të papagajve ashtu siç është përshkruar në tekst. Që sqarimi të konsiderohet i kompletuar doemos duhet të thuhet se llamba elektrike e lehtëson <u>gjetjen e papagajve natën</u> ose <u>të zbulohen papagajtë të cilët janë fshehur</u>.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ajo e ndihmon Hanën që t'i gjejë papagajtë në terr.</li> <li>- Ajo e përdorën llambën elektrike që të gjejë se ku janë fshehur papagajtë.</li> </ul>
<b>1 - Kompetencë e pjesshme</b>	<p>Përgjigje të cilat tregojnë kompetencë të pjesshme përmes ndarjes së informacioneve të përgjithshme nga teksti që të sqarohet se si Hana e përdorën llambën elektrike.</p> <p><u>Prova:</u> Përgjigjja përmban sqarim përkatës, por të përgjithshkëm se si Hana e përdorën llambën elektrike. Sqarimi nuk është jokonsistent me tekstin dhe mund të përmendet se Hana kujdeset për gjetjen e papagajve. Megjithatë, kjo <u>nuk përfshin</u> lidhje eksplicite me <u>gjetjen e papagajve natën</u> ose <u>gjetjen e papagajve të cilët janë fshehur</u>.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ajo i ndihmon që të endet nëpër fshat.</li> <li>- Ajo e përdorën sepse është natë.</li> <li>- Që t'i gjejë papagajtë.</li> <li>- Të endet nëpër fshat duke kërkuar vendet e errëta.</li> </ul>
<b>0 - Nuk ka kompetencë</b>	<p>Përgjigje që nuk tregojnë kompetencë se si Hana e përdorën llambën elektrike.</p> <p><u>Prova:</u> Në përgjigje nuk jepet sqarim përkatës mbi atë se si Hana e përdorën llambën elektrike. Në të mund të përmbahet sqarim i cili është i pasaktë ose nuk ka lidhje me tekstin. Përgjigjja mundet vetëm ta përsërisë informacionin në pyetje.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ajo e përdorën për në kamp.</li> <li>- Ajo e mban në dorë.</li> <li>- Ajo e përdorën që t'i shpëtojë papagajtë.</li> </ul>

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

## PAPAGAJTË E DETIT, AJTEMI 8

### 8. Sqaro se si Hana i përdorën kutitë e kartonit për t'i shpëtuar papagajtë e detit.

Lloji: Informativ

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<b>2 - Kompetencë e plotë</b>
<p>Përgjigje që tregojnë kompetencë të plotë përmes integritit të informacioneve specifike nga teksti për të sqaruar se si Hana i përdorën kutitë e kartonit.</p> <p><u>Prova:</u> Përgjigjja përmban sqarim përkatës mbi atë se si Hana i përdorën kutitë e kartonit. Në sqarim në mënyrë eksplicite përmbahet shpëtimi i papagajve ashtu siç është përshkruar në tekst. Që sqarimi të konsiderohet i kompletuar doemos duhet të thuhet që kutitë e kartonit e lehtësojnë <u>ruajtjen e sigurt të papagajve</u> ose bartjen e papagajve.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ajo i vendos papagajtë në kuti që të jenë të sigurt.</li><li>- Ajo i përdorën ato që t'i dërgojë papagajtë deri në plazh.</li><li>- Ajo i përdorën që t'i dërgojë papagajtë deri në shtëpi që t'i ruajë gjatë natës.</li><li>- Ajo i vendos të sigurt në kuti.</li></ul>
<b>1 - Kompetencë e pjesshme</b>
<p>Përgjigje të cilat tregojnë kompetencë të pjesshme përmes ndarjes së informacioneve të përgjithshme nga teksti që të sqarohet se si Hana i përdorën kutitë e kartonit.</p> <p><u>Prova:</u> Përgjigjja përmban sqarim përkatës, por të përgjithësuar se si Hana i përdorën kutitë e kartonit. Sqarimi nuk është jokonsistent me tekstin. Megjithatë, kjo <u>nuk përfshin</u> lidhje eksplicite me ruajtjen e sigurt të papagajve ose me bartjen e tyre.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ajo i vendos papagajtë në to.</li><li>- Ajo atje i ruan.</li><li>- Që t'i kap papagajtë. (Kujdes: kjo është mënyrë joprecize që të thuhet "ruan")</li></ul>
<b>0 - Nuk ka kompetencë</b>
<p>Përgjigje të cilat nuk tregojnë kompetencë se si hana i përdorën kutitë e kartonit.</p> <p><u>Prova:</u> Në përgjigje nuk jepet sqarim përkatës mbi atë se si hana i përdorën kutitë e kartonit. Në të mund të përmbahet sqarim që është i pasaktë ose që nuk është në lidhje me tekstin. Në përgjigje mundet vetëm të jetë i përsëritur informacioni nga pyetja.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ajo në kuti i fsheh nga miqtë.</li><li>- Ajo i përdorën kutitë për të bartur gjësende.</li><li>- Ajo i përdorën kutitë që t'i shpëtojë papagajtë.</li></ul>

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
8	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
9	Nuk ka përgjigje.

**10. Pse duhet të jetë ditë kur fëmijët i lirojnë papagajtë e detit? Përdori informacionet nga teksti për të sqaruar.**

Lloji: Informativ

Procesi: Nxjerrje e konkludimeve të drejtpërdrejta

<b>1 – Përgjigje të pranueshme</b>	
Përgjigje në të cilat është dhënë konkludim përkatës përse papagajtë doemos duhet të lirohen ditën. <u>Prova:</u> Në përgjigje është treguar kompetencë se papagajtë mund të jenë të hutuar natën ose që ata ditën mund ta shikojnë më mirë qëllimin e tyre (ujin) shumë më qartë. <u>Shembuj:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Në qoftë se papagajtë lirohen në terr, dritat e fshatit mund t'i tërheqin që të kthehen prapa.</li><li>- Në dritën e ditës papagajtë më mirë mund ta shikojnë rrugën e tyre deri te uji.</li><li>- Në atë mënyrë nuk do të jenë përsëri të hutuar.</li><li>- Ata duhet të shikojnë ku duhet të zbesin, e nuk mund të shikojnë në qoftë se është natë.</li></ul> Ose në përgjigje mund të jenë të theksuara dëshirat e fëmijëve që t'i lirojnë papagajtë në atë mënyrë që janë përmendur informacione specifike nga teksti në të cilat tregohet se drita e ditës është e domosdoshme. <u>Shembuj:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Për fëmijët do të ishte e vështirë të shikojnë se çfarë bëjnë në plazh natën.</li><li>- Mund të mos jetë sigurt për fëmijët që në terr ta kalojnë gjithë rrugën pranë plazhit.</li></ul>	
<b>0 - Përgjigje të papranueshme</b>	
Përgjigje të cilat nuk përmbajnë konkludime përkatëse mbi atë përse papagajtë doemos duhet të lirohen ditën. <u>Prova:</u> Në përgjigje nuk shikohet se është kuptuar se është më pak e mundur që papagajtë të jenë të hutuar në dritën e ditës. Ajo mund përmbajë sqarim qarkor ose sqarim të papërcaktuar mbi atë se përse është më lehtë për fëmijët ose për papagajtë gjatë ditës, por nuk janë përdorur informacione specifike nga teksti që të mbështetet sqarimi. <u>Shembuj:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Sepse fëmijët nuk mund të shikojnë natën.</li><li>- Papagajtë mund të shikojnë. (Ose të shikojnë se ku fluturojnë.)</li><li>- Ata duhet të shikojnë se ku shkojnë.</li></ul>	
<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

**12. Shkruaj dy ndjenja të ndryshme të cilat Hana ndoshta i ka pasur pasi i ka lëshuar papagajtë e detit në liri. Sqaro pse ka mundur ta ketë secilën prej ndjenjave.**

Lloji: Informativ

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<p><b>2 - Kompetencë e plotë</b></p> <p>Përgjigje të cilat tregojnë kompetencë të plotë përmes gjetjes së mendimeve nga teksti që të zbulohen dhe sqarohen ndjenjat e Hanës.</p> <p><u>Prova:</u> Përgjigjja përmban dy ndjenja të ndryshme dhe jep nga një sqarim përkatës për secilën ndjenjë (dy ndjenja + dy sqarime). Që të dy ndjenjat që janë veçuar mund të jenë pozitive ose negative ose mund të bëhet fjalë për ndjenja konfliktuoze. Sqarimi për secilën ndjenjë nxirret nga informacione të ndryshme nga teksti dhe ndoshta ky është sqarimi për ndjenjat e tilla.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ajo është ndjerë e pikëlluar kur u jepte lamtumirën (kur u thoshte “mirupafshim”) papagajve të detit. Por, ajo është e lumtur që i ka sjellë pranë ujit.</li><li>- Ajo është e lumtur sepse ata kishin shpëtuar. Dhe asaj i lehtësohej sepse ata nuk ishin kapur nga macet ose qentë.</li><li>- Ajo është e lumtur sepse i kishte shpëtuar nga rreziku, por, po ashtu, është edhe e pikëlluar sepse disa janë ngrënë nga qentë dhe macet. (Vërejtje: sqarimi i ndjenjave të pikëlluara të saj është i pranueshëm sepse është e mundur që papagajtë të cilët ajo nuk i ka shpëtuar nuk kanë mbijetuar. Megjithatë, referimi në një rrezik të ardhshëm nuk mund të pranohet.)</li><li>- Ajo është e kënaqur sepse ka ndihmuar që të shpëtohen jetët e tyre. Mirëpo ajo është e pikëlluar sepse ndoshta ka dashur të luajë me to. (Sqarimi i dhënë në këtë përgjigje për ndjenjën e “pikëlluar” të saj mund të pranohet. Ndoshta edhe është se Hana ka dashur të luajë me to, edhe pse nuk ka tregues në tekst se ajo ka luajtur me to. Ky sqarim nuk konsiderohet si i pranueshëm në qoftë se sugjeron se ajo ka luajtur me to pasi i ka shpëtuar sepse kjo do të ishte jokonsistente me tekstin.</li></ul>
<p><b>1 - Kompetencë e pjesshme</b></p> <p>Përgjigje që tregojnë kompetencë të pjesshme të ndjenjave të Hanës.</p> <p><u>Prova:</u> Në përgjigje janë përmendur dy ndjenja të ndryshme. Të dy ndjenjat që janë veçuar mund të jenë pozitive ose negative ose mund të bëhet fjalë për ndjenja konfliktuoze. Megjithatë, një nga ndjenjat nuk mbështetet me informacion përkatës nga teksti.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ajo është e pikëlluar, por njëkohësisht edhe e lumtur sepse ata kanë shpëtuar.</li><li>- Hana është e kënaqur sepse u ka ndihmuar papagajve të detit të mbërrijnë te uji, por ajo po ashtu është e pikëlluar.</li></ul> <p>Ose në përgjigje është përmendur vetëm një ndjenjë dhe jepet vetëm një sqarim për atë ndjenjë që është e bazuar në informacion përkatës nga teksti.</p> <p><u>Shembull:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ajo është e lumtur sepse ka mundur t’u ndihmojë të mbërrijnë në det.</li></ul>

- 12. Shkruaj dy ndjenja të ndryshme të cilat Hana ndoshta i ka pasur pasi i ka lëshuar papagajtë e detit në liri. Sqaro pse ka mundur ta ketë secilën prej ndjenjave.**  
(vazhdon)

<b>0 - Nuk ka kompetencë</b>	
Në përgjigje nuk është treguar kompetencë e ndjenjave të Hanës.	
<u>Prova:</u>	
Në përgjigje mund të jenë të përmbajtura ose nuk janë të përmbajtura dy ndjenja. Nuk ka sqarim i cili është i bazuar në informacione të dhëna në tekst që të sqarohet ndonjë nga ndjenjat. Ose sqarimi bazohet në informacion joadekuat ose të pasaktë.	
<u>Shembuj:</u>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ajo ndjehej e lumtur dhe e pikëlluar.</li> <li>- Han iu thotë “mirupafshim” papagajve të detit.</li> <li>- Ajo është e lumtur që ka mundur të luajë me papagajtë e detit.</li> <li>- Kur i ka liruar ajo ndoshta ka qenë e pikëlluar sepse ata do të mund të ishin shkelur nga vetura.</li> </ul> (Vërejtje: Nuk ka prova në tekst që papagajtë do të mund të jenë në rrezik pasi që ata janë liruar).	

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.



**13. A do të dëshiroje ti të shkosh dhe të shpëtosh papagajtë e detit me Hanën dhe shokët e saj? Përdore atë që lexove që të të ndihmojë për ta sqaruar.**

Lloji: Informativ

Procesi: Analizë dhe vlerësimi i përmbajtjes, gjuhës dhe elementeve tekstuale

<b>2 - Kompetencë e plotë</b>	
Përgjigje që tregojnë kompetencë të plotë të tekstit përmes mbështetjes së vlerësimit personal të përmbajtjes së tij. <i>Prova:</i> Përgjigjia përmban mendim personal. Mendimi mbështetet me një informacion konkret nga teksti. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Po, do të ishte argëtuese t'i çojë deri në plazh.</li><li>- Jo nuk do të doja sepse nuk më pëlqen të mbledh zogj.</li></ul>	
<b>1 - Kompetencë e pjesshme</b>	
Përgjigje që tregojnë kompetencë të pjesshme të tekstit përmes mbështetjes së vlerësimit personal të përmbajtjes së tij. <i>Prova:</i> Përgjigjia përmban mendim personal i cili mbështetet me anë të përgjithësimi të përmbajtjes së tekstit. Përgjithësimi mund të jetë paraprakisht nga përvoja personale, por është i ndërlidhur me tekstin. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Do të doja t'i ndihmoj. Mendoj se është e rëndësishme të shpëtohen zogjtë.</li><li>- Jo, nuk do të doja. Duket se është mjaft vështirë që të shpëtohen.</li><li>- Po, do të doja. Unë kam shpëtuar kafshë më herët. (Vërejtje: Sqarimi që përmbahet në këtë përgjigje është më së shumti i bazuar në përvojën personale, mirëpo qartë i ndërlidhur me përmbajtjen e tekstit.)</li><li>- Po, do të doja t'i ndihmoj. Atë që ajo ka bërë ka qenë punë e mirë. (Vërejtje: Ky sqarim mund të konsiderohet i pranueshëm derisa është i mundshëm vlerësimi në bazë të përmbajtjes së tekstit.)</li></ul>	
<b>0 - Përgjigje e papranueshme</b>	
Përgjigje që nuk tregojnë aftësi të mbështetjes së vlerësimit personal në përmbajtjen e tekstit. <i>Prova:</i> Përgjigjia nuk përmban ose nuk përmban mendim personal. Nuk janë dhënë informacione nga teksti që të mbështetet mendimi personal. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Jo, nuk do të doja të shpëtoja papagaj deti. (Vërejtje: Kjo përgjigje vetëm e ripërsërit pyetjen.)</li><li>- Po, do të doja të shkoja me të.</li></ul> Ose përgjigjia përmban mendim personal që mbështetet me informacion i cili është i pasaktë ose nuk lidhet me tekstin. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Po, do të doja t'i kapja dhe t'i haja.</li><li>- Jo, Hana mund këtë ta bëjë pa ndihmën e kujt do qoftë.</li></ul> Ose përgjigjia përmban sqarim qarkor i cili e ripërsërit pyetjen pa u dhënë informacionet shtesë. <ul style="list-style-type: none"><li>- Po, sepse i shpëton papagajtë.</li></ul> Ose sqarimi është mjaft i përgjithësuar. <ul style="list-style-type: none"><li>- Jo, kjo do të ishte e mërzitshme.</li><li>- Po, do të ishte argëtuese.</li></ul>	

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
8	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
9	Nuk ka përgjigje.